



Nr. 01/ZDP/VE/2011

Datë: 23 shkurt 2011

Duke marrë parasysh kompetencat e Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës (më tej "AAC") sipas nenit 14.1 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil (më tej "LAC"),

Duke marrë parasysh përgjegjësitë e AAC-së sipas nenit 15.1 (d) të LAC, për lëshimin e licencave, certifikatave dhe lejeve për personelin e aviacionit,

Në mbështetje të nenit 21.2 të LAC për lëshimin e akteve administrative të nevojshme,

Me qëllim të lëshimit të certifikatës për Qendra të Mjekësisë së Aviacionit në pajtim me Rregulloren e AAC-së Nr. 01/2010, datë 15 janar 2010, Rregulloren 04/2008 për licencimin e kontrollorëve të trafikut ajror, datë 29 dhjetor 2008, e ndryshuar me Rregulloren 13/2010, dhe Udhëzimit Administrativ të AAC-së Nr. 01/2011, datë 3 shkurt 2011,

Duke vepruar sipas rekomandimit të ekipit për përzgjedhjen e Qendrave të Mjekësisë së Aviacionit për kryerjen e ekzaminimeve mjekësore për personelin e aviacionit, datë 5 janar 2011, të udhëhequr nga Dr. Naim Bardiqi, Ekzaminues i Autorizuar Mjekësor (AME) nga AAC-ja, me Nr. Licence KS/AME/01,

Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së, merr këtë:

VENDIM

Neni 1

"Instituti Kombëtar i Mjekësisë së Punës", me adresë rr. Nëna Terezë nr. 1, Gjakovë, autorizohet si Qendër e Mjekësisë së Aviacionit (më tej "AMC") në Republikën e Kosovës nga data 24 shkurt 2011 deri më 23 shkurt 2014.

Neni 2

Obligohet AMC-ja që gjatë punës në shërbim të personelit të aviacionit, të bashkëpunojë ngushtë me ekzaminuesit autorizuar mjekësorë (AME) nga AAC-ja, t'i përmbahet me përpikëri rregullave dhe standardeve të mirësjelljes dhe korrektësisë, dhe dispozitave të rregulloreve përkatëse të AAC-së.

Neni 3

Personeli i aviacionit, i cili shfrytëzon shërbimet e AMC-së nga neni 1, duhet të paguajë për shërbimet e të gjitha ekzaminimeve të nevojshme mjekësore. AMC-ja është e autorizuar të ngarkojë personelin e aviacionit për mbulimin e këtyre shpenzimeve në përputhje me çmimoren e saj, në bazë të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Shëndetësisë Nr. 04/2007.

Neni 4

Për lëshimin e këtij Vendimi nuk paguhet tarifë nga AMC-ja.

Neni 5

Ky Vendim mund të tërhiqet nëse vërtetohet se AMC-ja ka bërë shkelje të nenit 2 më lart.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi më 23 shkurt 2011.




Dritan Gjonbalaj
Drejtore i Përgjithshëm